

## SHËNIME METODOLOGJIKE PËR KOMPILIMIN E POZICIONIT NDËRKOMBËTAR TË INVESTIMEVE TË SHQIPËRISË.

Në kuadrin e kompilimit të statistikave të sektorit të jashtëm të ekonomisë, Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për kompilimin e Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve të vendit (PNI). Të dhënat për kompilimin e PNI-së përpunohen nga Sektori i Bilancit të Pagesave në departamentin e statistikave të BSh-së, duke respektuar rregullat e konfidencialitetit. Pasqyra e PNI-së përpilohet në përputhje me standardet ndërkombëtare të përshkruara në *“Manuali i Statistikave të Bilancit të Pagesave, Edicioni i Pestë”* (FMN, 1993) dhe në *“Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve – Një Udhëzues për Burimet e Informacionit”* (FMN, 2002).

Ekziston një lidhje e ngushtë mes Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve dhe Bilancit të Pagesave. Llogaria financiare e BP-së mat transaksionet e ekonomisë në mjete dhe detyrime të jashtme financiare, të cilat ndikojnë mbi stokun e mjeteve dhe detyrimeve të jashtme financiare të matura nga PNI.

### I. PARIME TË VLERËSIMIT

Pozicioni ndërkombëtar i investimeve është gjendja e bilancit të pretendimeve dhe detyrimeve të huaja financiare në një moment të caktuar kohe.

Të dhënat në pasqyrën e PNI-së, paraqiten në milion Lekë. Për stokun e mjeteve dhe detyrimeve në monedha të tjera, konvertimi në Lekë bëhet me kursin zyrtar të këmbimit të datës së fundit të periudhës së raportimit, ndërsa për transaksionet në mjete dhe detyrime në monedha të tjera, konvertimi në Lekë bëhet me kursin mesatar zyrtar të këmbimit për periudhën. Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit është përfshirë në vlerësimin e stokut të mjeteve dhe detyrimeve. Këto rregullime bëhen sipas metodologjisë së FMN-së.

Në parim, të gjitha mjetet dhe detyrimet financiare duhet të jenë të matura me çmimet korente të tregut në datën e shkaktuar (domethënë në fillim ose në fund të periudhës së referuar). Për vlerësimin e stokut të instrumenteve të PNI-së për të cilat nuk është i mundshëm përdorimi i vlerës së tregut është përdorur vlera e tyre kontabël ose ajo nominale.

Pasqyra e PNI-së së Shqipërisë kompilohet në bazë vjetore. Të dhënat paraprake (në lidhje me të dhënat për IHD-në) përgatiten për publikim brenda një tremujori nga fundi i vitit të referencës. Këto të dhëna revizionohen me marrjen e të dhënave me të fundit, dhe pasqyra me të dhënat përfundimtare të PNI-së, përgatitet për publikim brenda tre tremujorëve nga fundi i vitit të referencës, siç kërkohet në standardet ndërkombëtare të shpërndarjes së të dhënave. (GDDS dhe SDDS)

## **II. ELEMENTËT PËRBËRËS TË POZICIONIT NDËRKOMBËTAR TË INVESTIMIT**

Zërat financiarë që përfshihen në Pozicionin Ndërkombëtar të Investimeve konsistojnë në: pretendime mbi jo-rezidentët, detyrime të jo-rezidentëve, dhe rezerva ndërkombëtare.

Klasifikimi kryesor i pasqyrës së PNI-së është ai mes mjeteve dhe detyrimeve. Diferenca ndërmjet tyre paraqet pozicionin neto të investimeve.

Klasifikimi i mëtejshëm sipas funksionit është plotësisht në përputhje me klasifikimin e zërave të llogarisë kapitale dhe financiare të bilancit të pagesave. Kategoritë funksionale të mjeteve dhe detyrimeve janë: (i) investimet direkte, (ii) investimet e portofolit, (iii) derivativët financiarë, dhe (iv) investime të tjera. Në mjetet e huaja përfshihen edhe (v) mjetet e rezervës të mbajtura nga autoriteti monetar.

Niveli i tretë i klasifikimit të PNI-së është ndarja sektoriale e mjeteve dhe detyrimeve financiare, në përputhje me klasifikimet dhe përcaktimet e statistikave të bilancit të pagesave. Investimet klasifikohen në bazë të

sektorëve institucionalë siç janë sektori i qeverisë së përgjithshme, autoriteti monetar, sistemi bankar dhe sektorë të tjerë.

#### **A. INVESTIMI DIREKT**

Investim direkt është një kategori e investimeve ndërkombëtare, në të cilën një rezident i një ekonomie – investitori direkt – zotëron një interes të qëndrueshëm (të paktën 10 për qind të aksioneve) në një ndërmarrje rezidente – ndërmarrja e investimit direkt. Investimi direkt përfshin së bashku transaksionin fillestar, për vendosjen e marrëdhënies ndërmjet investitorit dhe ndërmarrjes, dhe të gjitha transaksionet kapitale pasuese ndërmjet tyre. Parimi i regjistrimit është i drejtpërdrejtë: investimi direkt jashtë si një mjet, dhe investimi direkt në Shqipëri, si një detyrim. Investimet direkte përbehen nga tre komponentë: investimet në kapital, fitimet e riinvestuara, dhe kapitale të tjera (transaksionet e borxhit ndërmjet kompanive të lidhura). Sipas standardeve ndërkombëtare, për sa i përket klasifikimit, pretendimet mbi dhe detyrimet ndaj ndërmarrjeve të lidhura, duhet të regjistrohen si përbërës më vete të investimeve direkte.

#### *Burimet e informacionit dhe metoda e përpunimit:*

Të dhënat për investimin e huaj në bankat tregtare dhe institucionet financiare jo-banka merren nga bilancet e tyre kontabël, apo format e tjera të raportimit të tyre direkt në Bankën e Shqipërisë në kuadër të Sistemit të Unifikuar të Raportimit (SRU). Për sektorët e tjerë jo financiarë, informacioni mbi pozicionin vjetor të Investimit të Huaj Direkt (IHD), sigurohet nga vrojtimet e përvitshme të kryera nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me INSTAT, mbi ndërmarrjet me kapital të huaj ose të përbashkët. Informacion i mëtejshëm për flukse hyrëse të investimit të huaj direkt në formën e privatizimeve, merret nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Të dhënat raportohen në pasqyrën e PNI-së të ndara mes stokut të kapitalit, fitimeve të riinvestuara, dhe kapitaleve të tjera. Në pasqyrën paraprake të PNI-së, për zërin e investimeve direkte, vendoset paraprakisht vlera e transaksionit sipas të dhënave të BP-së, e cila revizionohet më pas me të dhënat e marra nga vrojtimi i radhës mbi IHD-të, brenda tremujorit të tretë, pas fundit të vitit të referencës.

## **B. INVESTIMET E PORTOFOLIT**

Stoku i investimeve të portofolit përfshin zotërime dhe detyrime në letra me vlerë të pasurisë (aksionet) dhe të borxhit; këto të fundit ndahen në obligacione dhe kambiale (me afat maturimi 1 - vjeçar ose më të lartë) dhe instrumente të tregut monetar (me afat maturimi më pak se një vit).

### *Burimet e informacionit dhe metoda e përpunimit:*

Informacioni për investimet e portofolit merret nga sistemi raportues i bankave tregtare dhe institucioneve financiare jo-banka, të cilat kanë investuar në letra me vlerë të emetuara nga jo-rezidentë (aktualisht nga qeveri të huaja). Së shpejti do të mblidhet informacion edhe nga kompanitë e sigurimit dhe institucione të tjera financiare.

Në rastet kur nuk është i mundur përdorimi i vlerës së tregut të këtyre letrave me vlerë, për të arritur në një vlerë të afërt me atë të tregut, prej vlerës nominale zbriten skontot (ose premiumet) dhe shtohen interesat e përlllogaritura.

## **C. DERIVATIVËT FINANCIARË**

Derivatvët financiarë përfshijnë instrumente të tilla si garancitë, kontratat e tregtueshme të së ardhmes mbi një instrument financiar, opsionet (mbi monedhat, normat e interesit, mallrat etj). Banka e Shqipërisë nuk ka akoma informacion për stokun e këtij përbërësi të PNI-së.

#### D. INVESTIME TË TJERA

Investime të tjera përfshijnë stokun e mjeteve dhe detyrimeve për periudha afatshkurtra dhe afatgjata, të kredisë tregtare dhe huamarrjes, monedhave dhe depozitave si dhe mjeteve e detyrimeve të tjera (llogari të arkëtueshme e të pagueshme).

Sipas BPM5 *kredia tregtare* përfaqëson pretendimet dhe detyrimet e rrjedhura nga zgjatja e afatit të kredisë mes furnitorit dhe blerësit, për transaksione në mallra dhe shërbime, si dhe parapagime për marrëveshje të lidhura (ose që do të ndërmerren) për të tilla transaksione. Duhet të theksohet, që huadhënia që aplikohet për financimin e tregtisë nuk konsiderohet kredi tregtare sipas përcaktimeve të bilancit të pagesave dhe PNI-së.

*Huatë* përfshijnë ato mjete financiare të krijuara përmes huadhënies direkte të fondeve nga një kreditor (huadhënësi) për një debitor (huamarrësi), kur palët janë njëri rezident e tjetri jo-rezident.

Zëri *monedha dhe depozita* përfaqëson stokun e monedhave dhe depozitave në valutë, të zotëruara nga rezidentët në bankat jo-rezidente dhe depozitat e jo-rezidentëve në sistemin tonë bankar.

Zërat *mjetet të tjera dhe detyrime të tjera* përfshijnë të tjera pretendime dhe detyrime nga/tek jo-rezidentët të pa përfshira në zërat të tjerë. Të përfshira nën këto zëra janë, gjithashtu, vonesa në huadhënie nga rezidentët – regjistruar nën mjete – dhe huamarrje e rezidentëve nga jashtë – regjistruar si detyrim.

#### Burimet e informacionit dhe metoda e përpunimit:

Të dhënat për detyrimet në formën e *kredisë tregtare* llogariten mbi të dhënat e importit duke aplikuar koeficientet dhe afatet e maturimit sipas grupmallrave, që rezultojnë nga vrojtimi i tregtisë i cili kryhet nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me INSTAT.

Të dhënat për stokun e zërit *Hua* merren nga: sistemi bankar; institucionet financiare jo-banka; Ministria e Financës për borxhin e qeverisë së përgjithshme; departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe i Komunikimit për borxhin e Autoritetit Monetar; organizata dhe institucione të tjera ndërkombëtare për huadhëniet për ndërmarrjet, si Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim dhe Fondi Amerikano Shqiptar i Ndërmarrjeve.

Vlera e transaksionit për huatë afat-gjata del si diferencë mes tërheqjeve dhe principalit të paguar gjatë periudhës. Shuarjet e borxhit gjatë periudhës regjistrohen si rregullime të tjera, ndërsa vonesat në pagesa si detyrime të tjera.

Vlera e disa huave afat gjata të marra para vitit 1990 është ende subjekt negociimesh politike midis palëve. Në pasqyrën e PNI-së këto hua vlerësohen me një vlerë të përafërt dhe janë subjekt revizionimesh deri në momentin e përfundimit të negociimeve të tyre kur ato të pasqyrohen me vlerën e tyre reale.

Të dhënat mbi *monedhat dhe depozitat* përfshijnë mbajtjen e valutës së huaj të Bankës së Shqipërisë siç raportohet në bilancin e saj kontabël; mbajtjet e llogarive personale të individëve ose personave fizik në bankat jo-rezidente siç raportohet nga Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë; si dhe monedha e depozita në valutë të huaj që mbajnë bankat tregtare (mjete ose detyrime) dhe institucionet e tjera financiare jo-banka (mjete) siç pasqyrohen në format e raportimit të tyre në BSh.

Vlera e depozitave dhe huave përfshin edhe interesin e përllogaritur për to në fund të periudhës, i cili pasqyrohet veçmas në llogarinë e të ardhurave në Bilancin e Pagesave.

Të dhënat për *investime të tjera* përfshijnë llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme që raportohen nga bankat tregtare si dhe nga institucionet e tjera financiare jo-banka.

#### **E. MJETET E REZERVËS**

Sipas BPM5, *mjetet e rezervës* përbëhen nga mjete të huaja që janë lehtësisht të disponueshme dhe të kontrolluara nga autoriteti monetar për financim të drejtpërdrejtë të mosbalancimeve të pagesave dhe/ose për arsye të tjera. Mjetet e rezervës përfshijnë arin monetar, SDR-të, pozicionin e rezervës në Fond dhe mjetet në valutë të huaj (që përbëhen nga monedha, depozita dhe letra me vlerë).

Të dhënat për mjetet e rezervës përgatiten bazuar mbi raportimet e marra nga Departamenti i Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë. Të dhënat konsiderohen të jenë shumë të sakta dhe nuk ngrenë asnjë problem klasifikimi.